



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

---

**AD-GJTHPZ.nr.8/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesve N.K., I.F., dhe A.K., ndaj trupit gjykues, gjyqtarëve R.E., kryetare e trupit gjykues dhe anëtarëve T.K., dhe N.V., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e trupit gjykues sipas lëndës penale PKR.nr.203/22, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.05.08.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesve N.K., I.F., dhe A.K., ndaj trupit gjykues, gjyqtarëve R.E., kryetare e trupit gjykues dhe anëtarëve T.K., dhe N.V., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e trupit gjykues sipas lëndës penale PKR.nr.203/22.

**A r s y e t i m**

Parashtruesit e ankesës N.K., I.F., dhe A.K., me datë 04.07.2024 pranë Këshillit Gjyqësor të Kosovës kanë parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj trupit gjykues, gjyqtarëve R.E., kryetare e trupit gjykues dhe anëtarëve T.K., dhe N.V., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e trupit gjykues sipas lëndës penale PKR.nr.203/22. Kjo kërkesë përmes KGJK-së me datë 10.07.2024 është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prizren.

Ankuesit N.K., I.F., dhe A.K., në kërkesën e paraqitur kanë deklaruar se, trupi gjykues nuk ka respektuar Nenin 5, Nenin 7, Nenin 8, Nenin 9 Nenin 3 IO të Kodit nr.08/L-032 të Procedurës Penale dhe ka mohuar të drejtën e mbrojtjes adekuate ligjore gjatë seancave, duke i përkrahur dhe devijuar thëniet e prokurorit edhe pse janë palët të barabartë në procedurë, duke i shkelur të akuzuarve dhe të mbrojtësve të tyre të drejtën gjatë dhënies së mbrojtjes, duke shkelur parimin e paanshmërisë dhe duke prejudikuar epilogun e rastit pa administrimin e

provave dhe fakteve, e po ashtu duke i anashkaluar deklaratat e dhëna nga pala e dëmtuar në këtë çështje. Po ashtu, kanë deklaruar se procedura në këtë çështje zhvillohet me zvarritje duke i shtyrë seancat pa ndonjë arsye apo fakt në dëm të të akuzuarve, meqenëse procedura në këtë çështje sa i përket afatit kohor të zhvillimit, ka skaduar një kohë shumë të gjatë mbi I (një) vit, që është në kundërshtim me nenin 310 të KPPRK-së. Kërkojnë një gjykim të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara nga institucionet përgjegjëse gjyqësore si dhe mos neglizhencën e rastit. Andaj, kërkojnë që të fillohet procedura disiplinore nda trupit gjykues të këtij rasti duke ia bashkëngjitur edhe procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 01.07.2024 dhe vendimin e Prokurorisë Themelore në Prizren me supozim se kemi të bëjmë me rastin e ndërlikuar të cilin vendim trupi gjykues e ka pranuar si njëra prej arsyeve të shtyrjes së seancës, duke theksuar se prokuroria dhe gjykata janë duke manipuluar me lëndën e cila është pa fakte dhe prova dhe kërkojnë që nga shkresat e lëndës të lexohet deklarata e palës së dëmtuar M.B., ku i njëjti ka theksuar se nuk janë këta persona që i kanë shkaktuar dëm, por janë disa të tjerë të cilëve i ka përmendur emrat e tyre, ndërsa gjykata e prokuroria nuk i marrin parasysh këto deklarata.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj trupit gjykues, gjyqtarëve R.E., kryetare e trupit gjykues dhe anëtarëve T.K., dhe N.V., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, lidhur me veprimet dhe sjelljen e trupit gjykues sipas lëndës penale PKR.nr.203/22, ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga trupi gjykues si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndës penale PKR.nr.203/22.

Gjyqtarja R.E., në cilësinë e kryetares së trupit gjykues në deklaratën e saj lidhur e pretendimet e ankuesve ka cekur se lidhur me menaxhimin e rastit dhe seancave të mbajtura në këtë çështje penale nga procesverbalet P.nr.203/22 mund të vërtetohet se asnjë seancë nuk është shtyrë për shkak të mungesës së kryetares së trupit gjykues apo anëtarëve dhe në çdo rast shtyrja e seancave ka qenë me propozimin e palëve ose për arsye të pranueshme. Si kryetare e trupit gjykues, gjatë seancave ka respektuar procedurën ligjore dhe ka respektuar të drejtat e të pandehurve dhe të mbrojtësve të tyre. Konsideron se nuk ka shkelur Kodin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, respektivisht neni 5 që ka të bëjë me gjykim të drejtë, paanshëm dhe në afat të arsyeshëm. Së bashku me deklaratën ia ka bashkëngjitur edhe procesverbalet në kopje prej seancës fillestare deri më datë 03.07.2024, ku me pëlqimin e palëve është caktuar seanca e radhës, për datë 10.10.2024 dhe 11.10.2024.

Gjyqtarët T.K., dhe N.V., në cilësinë e anëtarëve të trupit gjykues në këtë çështje penale, kanë deklaruar se me datë 03.07.2024 në ora 09:30 minuta, ka filluar seancën e shqyrtimit gjyqësor, në çështjen penale të akuzuarve: N.K., I.F., dhe A.K., nga Prizreni, për veprat penale me të cilat ngarkohen, ashtu që gjatë kësaj seance nga ana e kryetares së trupit gjykues — gjyqtarës R.E., në procesverbal është konstatuar prezenca e palëve në procedurë. Po ashtu, kryetarja e trupit gjykues përmes prokurorit të shtetit ka konstatuar edhe arsyen e mos prezencës së prokurorit të çështjes, e cila ka udhëhequr me këtë procedurë në të gjitha fazat, mirëpo e njëjta për shkaqe shëndetësore nuk ka qenë prezent pasi që kurimi ndaj saj ka vazhduar dhe ka qenë në pushim mjekësor në trajtim të vazhdueshëm. Prokurori i shtetit i cili ka prezantuar në seancën e datës 03.07.2024, ka njoftuar trupin gjykues dhe palët tjerë në procedurë, avokatët, të akuzuarit dhe të dëmtuarin, në detaje për mos prezencën e koleges — prokurorit të çështjes. Po ashtu, prokurori i shtetit duke pasur parasysh kompleksitetin e lëndës dhe vendimin nën numrin PP/I.nr.1 19/2019 të datës 21.12.2022, nxjerre nga ana e Kryeprokurorit të Prokurorisë

Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 6 par.2.5 dhe nenit 6 par.3 të Udhëzimit Administrativë me numër 01/2018, që ka të bëjë me ndërlikueshmërinë e lëndës, me ç'rast edhe lënda nën numrin PKR.nr.203/2022 bënë pjesë në këtë grup të lëndëve, pasi që janë të përfshirë katër të akuzuar, të cilët ngarkohen me shumë vepra penale të natyrës së rëndë, nga gjykata kërkoi që kjo seancë të shtyhet për një datë të arsyeshme. Gjykata në pa mundësi të vazhdimi të seancës së shqyrtimit gjyqësor, në pajtim me agjendën e palëve në procedurë, ka caktuar seancat dhe atë për datë 10.10.2024 dhe 12.10.2024, në mënyrë që kjo lëndë të kryhet në afat optimal.

Po ashtu, vlen të theksohet se në këtë çështje penale trupi gjykues i vetëdijshëm për rëndësinë e lëndës dhe po ashtu duke pasur parasysh nenin 4 të Konventës Europjane për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut — konkretisht drejta në gjykim të drejtë, të pa anshëm dhe në afat të arsyeshëm, çdo herë ka caktuar seancat disa ditë me radhë, në mënyrë që lënda të kryhet në afat optimal. Po ashtu në këtë çështje penale asnjëherë seanca nuk është shtyrë për shkak të lëshimeve nga ana e gjykatës, por seanca është shtyrë për shkak të rrethanave tjera e cila është paraqitur si në rastin konkret e që nuk ka të bëjë me neglizhencën e trupit gjykues. Prandaj, trupi gjykues nuk ka shkelë dispozitat procedurale në këtë çështje penale sa i për ketë pretendimeve të akuzuarve, siç është parashtruar në parashtrësën me shkrim të datës 04.07.2024.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratat nga trupit gjykues dhe ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës PKR.nr.203/22.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — Departamenti për Krime të Rënda është në punë çështja penale PKR.nr.203/22 ndaj të akuzuarve N.K., nga Prizreni, për shkak të veprave penale fajdeja nga neni 331 par.3 lidhur me par. I të KPRK-së, detyrimi nga neni 328 par.2 të KPRK-së dhe dhënia e ryshfetit nga neni 422 par.3 lidhur me par. I të KPRK-së, të cilin e përfaqëson av.N.M., nga Prizreni, I.F., nga Prizreni për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 421 par.3 lidhur me par. I të KPRK-së, të cilin e përfaqëson av.S.H., nga Prizreni, K.G., nga Prizreni për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me par.3 pika 3.1 dhe 3.2 të KPRK-së të cilin e përfaqëson av. S.M., nga Prizreni dhe A.K., dhe N.K., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së të cilën e përfaqëson av. A.M., nga Prizreni, i dëmtuar në rastin konkret është M.B., të cilin e përfaqëson av. N.E., nga Prizreni.

Nga të lartcekurat si Autoritet Kompetent kam konstatuar se në rastin konkret Kryetarja e trupit gjykues ka pranuar lëndën P.nr.203/22 me dt.22.12.2022 (Aktakuza PP/I.nr.119/20 është ngritur 21.12.2022). Shqyrtimi fillestar është caktuar me dt. 25.01.2023 ku të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë dhe kanë parashtruar kërkesë për hedhjen e aktakuzës për të cilën kërkesë trupi gjykues ka caktuar seancë me dt. 03.03.2023 e cila është mbajtur dhe me propozim të palëve është shtyrë për dt.21.03.2023 ku është vendosur për Kërkesën për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimit të provave. Shqyrtimi gjyqësor është caktuar me dt. 11. 10.2023 dhe 12.10.2023 ku me dt. 11.10.2023 është mbajtur dhe në këtë shqyrtim është parashtruar

propozimi i av. N.M., për ekzaminim psikiatrik të dëmtuarit M.B., të cilin propozim e ka aprovuar gjykata dhe shqyrtimi për dt. 12.10.2023 është anuluar dhe është vendosur që shqyrtimi i radhës do të caktohet pas pranimit të raportit mjekësor. Shqyrtimi i radhës i caktuar me dt. 26.12.2023 nuk është mbajtur për shkak se trupi gjykues nuk ka qenë në përbërje të plotë sepse anëtari i trupit gjykues N.V., ka pasur rast vdekje. Shqyrtime e radhës janë caktuar me dt. 11.03.2024 dhe 12.03.2024. Në shqyrtim me dt. 11.03.2024 Kryetarja e trupit gjykues ka konstatuar se e akuzuara A.K., ka revokuar autorizimin av. B.C., dhe ka angazhuar avokaten A.M., , me dt. 07.03.2024, e Cila po atë ditë me autorizim zëvendësues ka autorizuar av. J.R., që ta zëvendëson për shqyrtim. AV. J.R., ka deklaruar se nuk posedon shkresa të lëndës dhe ka kërkuar që ti dorëzohen të gjitha shkresat dhe që shqyrtimi të shtyhet në mënyrë që ai të përgatitet për mbrojtje. Është aprovuar kërkesa e tij dhe shqyrtimi është shtyrë dhe është caktuar me dt. 02.05.2024 dhe 03.05.2024. Me dt. 02.05.2024 është mbajtur me rregull shqyrtimi kryesor i cili ka vazhduar me dt. 03.05.2024.

Në shqyrtimin e caktuar me dt.03.07.2024 nuk ka prezantuar Prokurorja e rastit E.G., të cilën e ka zëvendësuar prokurori P.K., Prokurori që në fillim të shqyrtimit ka informuar gjykatën se prokurorja e rastit është në pushim mjekësor dhe se ai lëndën e ka pranuar atë ditë dhe duke pasur parasysh ndërlikueshmërinë e rastit dhe faktit se nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të përgatitet për shqyrtim ka propozuar që shqyrtimi të shtyhet. Këtë propozim ka kundërshtuar av. N.M., av. S.H., ka cekur se pajtohet se nuk ka kushte për mbajtjen e shqyrtimit , kurse palët tjerë dhe avokatët e tyre nuk janë deklaruar ashtu që gjykata ka vendosur se shqyrtimi nuk do të mbahet dhe është caktuar me dt. 10.11.2024 dhe 11.10.2024.

Duke analizuar rrjedhën e seancave dhe shqyrtime të mbajtura dhe ato të cilat nuk janë mbajtur , arsyet dhe shkaqet të cilat kanë rezultuar për shtyerje të shqyrtimeve konsideroj se të njëjtat janë të arsyeshme dhe të bazuara në ligji. Është fakt se gjyqtarja ka caktuar seancën e parë përgatitore në afat ligjor kur e ka pranuar lëndën dhe të gjitha shqyrtimet e caktuara kanë pasur rrjedhën e vet bazuar në dispozitat e procedurës penale dhe kërkesat të cilat janë parashtruar nga ana palëve në procedurë. Shqyrtimi i fundit për të cilën palët pretendojnë se nuk është mbajtur dhe është shtyrë me qëllim të zvarritjes nga ana e gjykatës dhe prokurorisë rezulton se është shtyrë për shkak të sëmundjes së prokurores së rastit dhe angazhimit të prokurorit tjetër ku konsideroj se është e arsyeshme që prokurori i cili e merr rastin rishtazi i duhet kohë për përgatitje duke pasur parasysh edhe faktin se rasti është përcaktuar si i ndërlikueshëm sipas Vendimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/I.nr. 119/2019 të dt.21.12.2022. Gjatë analizës së shkresave të lëndës është vërtetuar se një shqyrtim nuk është mbajtur për shkak të kërkesës së avokatit të ri të angazhuar(A.M.) dhe një shqyrtim nuk është mbajtur për shkak se njëri anëtar i trupit gjykues ka pasur një rast vdekje. Gjatë zhvillimit të procedurës gjykata ka vendosur për Kërkesën për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave i cili vendim është atakuar në Gjykatën e Apelit dhe është kthyer nga kjo gjykatë me dt. 29.05.2023, ka vendosur për Kërkesën për ekzaminim psikiatrik të dëmtuarit dhe për këtë është angazhuar SHSKUK në Prishtinë i cili raport është dorëzuar në Gjykatë me dt. 13.11.2023 dhe të gjitha këto kanë përcaktuar se si do të zhvillohet rrjedha e procedurës dhe sa do të zgjas gjykimi.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideroj se Gjyqtarët e trupit gjykues, Kryetarja e trupit R.E., dhe anëtarët e trupit gjykues T.K., dhe N.V., në veprimet e tyre nuk kanë pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë shkelje sa i përket gjykimit të drejtë dhe të paanshëm në afat të arsyeshëm.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**AD-GJTHPZ.nr.8/2024, me dt.05.08.2024**

8.2024

Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emra



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.